



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA KUSHOVE
GRAMSH

Nr. 597/Prot.

Kushove me 19.09.2013

23

KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin

“Rikonstruksion shkolla 9 – vjecare Sotire, Komuna Kushove Gramsh”

E lidhur sot ne dt.19.09.2013 ne Komunen Kushove, Gramsh mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve, bazuar ne dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, neni 58, sipas kushteve te meposhteme:

KREU I : KUSHTET E VEÇANTA

Punët

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

Autoriteti Kontraktor është Komuna Kushove, Gramsh, perfaqesuar nga kryetari, **z.Xhevair BORA** percaktuar me poshte si **“AUTORITETI KONTRAKTOR”**, qe nderhyn ne kete kontrate mbi bazen e te drejtave qe i jep Ligji nr.9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”,

Kontraktori është **Operatori Ekonomik, Shoqeria “BELADI” shpk**, e percaktuar me poshte si **“KONTRAKTUESI” (sipermarresi)**, me seli ne **Shirgjan, fshati Mjekes, Elbasan**, i regjistruar si person juridik, me **NIPT J62903254C** me administrator (drejtues ligjor) **Z.Tefik VENARI** i cili perfaqeson kete subjekt per detyrimet e kesaj kontrate,

Neni 2: Objekti

Autoriteti Kontraktor, mbi bazen e dokumentave qe disponon pas fitimit te tenderit te zhvilluar me date **06.09.2013** i beson Kontraktuesit (firmes **“BELADI” shpk**) kryerjen e punimeve per objektin **“Rikonstruksion shkolla 9 – vjecare Sotire, Komuna Kushove Gramsh”**, ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt, kundrejt pagimit te vleres se kontrates.



Neni 3: Kantieri

Kantieri i Punëve do të jetë: **KOMUNA KUSHOVE, GRAMSH.**

Neni 4: Vlera e kontrates

Vlera e objektit “**Rikonstruksion shkolla 9 – vjecare Sotire, Komuna Kushove Gramsh**”, eshte **9 783 196 Leke pa TVSH + 1 956 639 Leke TVSH = 11 739 835 Leke me TVSH (njembedhjetemilion e shtateqind e tridhjetete e nentemije e teteqind e tridhjetete e pese).**

Vlera eshte percaktuar nga preventivi i objektit qe eshte paraqitur si oferte nga firma “**BELADI shpk**”, ne tenderin e dates **06.09.2013.**

Pagesa do te behet ne numrin e llogarise te kontraktuesit 0001031134 *Ben*
ne Banken Roiffeisen Bank *al 4520231004000000000103113*

Monedha e pagesës do të jetë LEK.

Neni 5: Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve

Kontraktorit do t’i jepet leja për të hyrë në kantier menjehere me lidhjen e kontrates.

Kontraktuesi do te filloje punimet me date 19.10.2013 dhe Autoriteti Kontraktor eshte i detyruar qe brenda kesaj date te beje gati ambjentin e destinuar per tu rehabilituar.

Punimet per realizimin e objektit te siperpermendur duhet te perfundojne jo me vone se data 19.06.2014, pra kohezgjatja e punimeve eshte **9 (nente) muaj kalendarike, nga dita e lidhjes se kontrates**, kjo sipas afatit te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga firma “**BELADI shpk**” ne tender.

Per çdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakort te dy palet me shkrim.

Neni 6: Kushti i fillimi i punimeve

Neqoftese brenda 5 diteve nga data e nenshkrimit te kontrates, Kontraktuesi nuk i ka paraqitur me shkrim verejtjet qe ka ne lidhje me kushtet e kesaj kontrate per mundesine e realizimit te punimeve, keto quhen plotesisht dhe pa kushte te pranuar.

Neni 7: Nderprerja e punimeve

Kontraktuesi eshte e detyruar te beje nderprerjen e punimeve edhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.

Mbetet e drejte e firmes ndertuese per te kerkuar zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe punimet jane nderprere nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 8: Sigurimi i Kontrates

Garancia e kontrates e paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates, sipas modelit perkates dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren **10 %** te vleres se kontrates ose ne vlere absolute **1 173 983,5 leke**. Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve kontraktuale nga sipermarresi.



Çlirimi i garancise se kontrates (10%) do te behet 30 dite, pas permbushjes se detyrimeve kontraktuale te Kontraktuesit, ose 30 dite pas kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te punimeve.

Neni 9: Garancia e punimeve

Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushtet teknike te percaktuara me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.

Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe **12 mujore**, duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.

Shuma e mbajtur per efekt te **garancise se defekteve** do te jete **5%** e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise (**12 muaj**).

Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 12-mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise se defekteve, si me siper.

Neni 10: Siguracioni

Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion dhe mban pergjegjesi, sipas legjislacionit ne fuqi, per:

- Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
- Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve.
- Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve:
- Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

Neni 11: Mbikqyesi i Punimeve

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve teknike te tij. Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi **Mbikqyres i Punimeve (supervisor)** do te jete Z. *Notasha Myrtaj*.

Kontraktuesi duhet ti nenshtrohet te gjitha dispozitave te mbikqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.

Neni 12: Inspektimet dhe Testimet, marrja ne dorezim e punimeve

Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë te gjithë kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje mbikqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve, ne zbatim te dispozitave ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor mund ti beje kontroll te gjithë dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve. Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithë demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.

Autoriteti Kontraktor do te kryeje verifikimin perfundimtar te punimeve te kryera, brenda 5 ditesh nga data e perfundimit te punimeve.

Autoriteti Kontraktor duhet qe verejtjet qe ka per punimet e kryera t'ia paraqese me shkrim Kontraktuesit, i cili eshte e detyruar ti riparoje brenda pese diteve nga marrja e njoftimit.



Marrja ne dorezim e objektit nga ana e Autoritetit Kontraktor behet nga grupi i marrjes ne dorezim, i ngritur me urdher te titulluarit te Autoritetit Kontraktor, pas kolaudimit te punimeve.

Neni 13: Lloji i Kontratës

Kjo kontratë do të çmohet si një **Kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin ne Njesi**

Neni 14: Ndryshime punimesh

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet, pervec atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor. Cdo ndryshim ne sasi i urdheruar nga Autoriteti Kontraktor, i cili sjell rritjen e vleres se kontrates do te jete detyrimisht objekt i nje Urdheri me shkrim nga Autoriteti Kontraktor, ne baze te nje propozim teknik te miratuar nga mbikqyresi i punimeve dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune, te parashikuar ne preventiv.

Neni 15: Grafiku i Pagesës

Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara, duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.

Kontraktuesi do ti dorezoje mbikqyresit te punimeve situacionin per punimet e kryera. Vlera e punes se kryer duhet te perfshije vleren e volumeve te perfunduara sipas cmimeve te zerave te punes te dhena ne preventiv. Situacioni do te firmoset nga mbikqyresi i punimeve, pasi te vertetohen punimet te kryera ne fakt.

Mund te perpilohen edhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).

Pagesa për Punët duhet bërë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument (situacionin) që deklaron se objektivi për pagesën është arritur, subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga mbikqyresi i punimeve.

kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

Cdo pagese do te behet sipas situacioneve te perfunduara te nenshkruar dhe te pranuar nga palet.

Neni 16: Te tjera

Parate e akorduara per kete projekt (Buxheti i Shtetit), per kryerjen e plote te ketij projekti jane ne vlere absolute sipas preventivit te projektit, ne leke, 12 247 011 Leke me TVSH, vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit per vitin 2013 sipas vendimit nr.5 date 16.04.2013, te Komitetit per Zhvillimin e Rajoneve, ne zbatim te shkreses nr.1352 prot., date 19.04.2013 te Kryeministrise, Departamentit te Bashkerendimit te Strategjive dhe Kordinimit te Ndhimes se Huaj. Mund te ndodhe qe edhe pse operatori te kete dorezuar situacione pjesore, KOMUNES KUSHOVE, GRAMSH mund t'i mungoje aftesia paguese per kete likuidim te pjesshem, pasi fondi perkates nuk i eshte akorduar ende. Ne te tilla raste (jashte vullnetit te autoritetit kontraktor), KOMUNA KUSHOVE, GRAMSH do te filloje likuidimet menjehere pas akordimit te fondit nga buxheti i shtetit.



Neni 17: Detyrimet e Kontraktuesit

Kontraktuesi (sipermarresi), me qellim qe te kryeje punen ne kushtet e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- te perfundoje objektin sipas volumeve dhe zerave te percaktuara ne preventiv, brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit,
- te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furnizimin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve,
- te marre persiper te gjitha pergjegjesite qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

Neni 18: Demet

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryera deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese, kur per to nuk eshte shkak forca madhore.

Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi civile dhe penale per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuara ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

Neni 19: Detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Mbetet ne ngarkim te Autoritetit Kontraktor:

- sigurimi i skicave dhe mbikqyrja e punimeve,
- caktimi i drejtuesit teknik te punimeve,
- marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skices dhe preventivit te miratuar per kete qellim.
- pagesa e situacioneve.

Neni 20: Zgjidhja e mosmarreshjeve

Ne rast mosmarreshjesh, kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet, kompetence per zgjidhen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqsor Elbasan

Kjo kontrate pasi u hartua, u lexua nga te dyja palet, te cilat i gjeten te drejta dispozitat e saj dhe e nenshkruan ate respektivisht.

Kjo kontrate u hartua ne kater kopje origjinale, tre prej te cilave merren nga Autoriteti Kontraktor dhe nje kopje nga kontraktuesi.

Kontrata firmoset dhe vuloset ne cdo flete nga te dyja palet.

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR
Komuna Kushove, Gramsh

PER KONTRAKTUESIN
"BELADI shpk", Elbasan

KRYETARI
Xhevair BORA



Administratori
Tefik VENARI

